



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1488/3 prot.

Tiranë, më 20.06.2025

VENDIM

Nr. 18, datë 20.06.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, Drejtor i emisionit investigativ ”Vetting”, në News 24 (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), formularin e ankesës nr. 1488 prot., datë 28.05.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Vlorë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 05.05.2025, depozituar në adresat elektronike desilda.caci@vlora.gov.al, info@vlora.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Listën e plotë me lejet e ndërtimit të akorduara në vitin 2024 dhe emrat e subjekteve përkatëse.*
2. *Listën e plotë me lejet e ndërtimit të akorduara për periudhën 1 janar 2025 – 30 prill 2025 dhe emrat e subjekteve përkatëse.*
3. *Listën e plotë me lejet e zhvillimit të akorduara për periudhën 1 janar 2025 – 30 prill 2025 dhe emrat e subjekteve përkatëse.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 1488/1 Prot., datë 29.05.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar brenda datës 05.06.2025.

Në vijim, Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it datë 09.06.2025, bën me dije se me shkresën nr. 6927/1 prot., datë 05.06.2025 i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke i vendosur në dispozicion numrin e lejeve të ndërtimit të akorduara për vitin 2024 dhe për periudhën 1 janar 2025 - 30 prill 2025.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me e-mail-in regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1488/2 prot., datë 10.06.2025, me pretendimin se nuk ka marrë informacionin/dokumentacionin e kërkuar, ka vijuar ankimin, duke kërkuar nga Komisioneri detyrimin e Autoriteti Publik për të vendosur në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Vlorë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: “*1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*”. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë

e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Konstatohet se Autoriteti Publik në kthim përgjigjen nr. 6927/1 prot., datë 05.06.2025, ka vendosur në dispozicion numrin e lejeve të ndërtimit të akorduara, duke mos iu përmbajtur objektit të kërkesës për informacion. Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, bazuar në kufizimet që parashikon e neni 17 i LDI, si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë se në cilën pikë të këtij neni mbështet qëndrimin e tij. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “*Informacion publik*” konsiderohet *çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokumentacion, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: “*Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij*;”.

Referuar parashikimeve të nenit 15 të LDI, moskthimi i një përgjigjeje nga ana e Autoritetit Publik brenda afateve të parashikuara në ligj do të konsiderohet si refuzim i dhënies së informacionit/dokumentacionit në respekt të pikës 4 të nenit 15 të LDI, e cila shprehet se: “*...Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim...*”.

Po ashtu, bazuar në pikën 23 të nenit 5, të ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “*Subjekt i të dhënave*” është *çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor,*

ekonomik, kulturor ose shoqëror. Në këtë kuadër, emrat e subjekteve të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i`u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar. Konkretisht, në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, Drejtor i emisionit investigativ “Vetting”, në News 24, me nr. 1488 prot., datë 22.04.2025, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Vlorë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 05.05.2025, konkretisht: *“1. Listën e plotë me lejet e ndërtimit të akorduara në vitin 2024 dhe emrat e subjekteve përkatëse. 2. Listën e plotë me lejet e ndërtimit të akorduara për periudhën 1 janar 2025 – 30 prill 2025 dhe emrat e subjekteve përkatëse. 3. Listën e plotë me lejet e zhvillimit të akorduara për periudhën 1 janar 2025 – 30 prill 2025 dhe emrat e subjekteve përkatëse.”*, brenda datës 27.06.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 20.06.2025

KOMISIONERI

Besnik Dervishi